



ПРОГРАМА ЗА ПАРЛАМЕНТАРНА ПОДДРШКА
PROGRAMI PËR MBËSHITJE PARLAMENTARE
PARLIAMENT SUPPORT PROGRAMME



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC


Raporti nga monitorimi nr. 1/2026

-

VËSHTRIM MBI KUVENDIN: RAPORT NGA MONITORIMI I CILËSISË SË DEBATIT NË KUVEND (KORRIK-DHJETOR 2025)

AUTORË: ALEKSANDRA JOVEVSKA GJORGJEVIQ DHE JOANA TRENESKA

SHKURT 2026



IMPLEMENTUAR NGA:



Ky publikim është përpiluar në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PMP), projekt i Qeverisë së Zvicrës nën patronazhin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. PMP zbatohet nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Instituti për Demokraci "Societas Civilis"- Shkup (IDSCS) dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime (QMN). Opinionet, pikëpamjet dhe përmbajtja e shprehur nuk pasqyrojnë pikëpamjet e projektit, donatorit dhe zbatuesit.

PËRMBAJTJA

I.	METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	5
II.	HYRJE DHE KONTEKSTI I POLITIKAVE	7
III.	REZYME	10
IV.	CILËSIA E DEBATIT	15
	Nota për cilësinë e debatit	15
	Lloji i diskutimeve	16
	Shkalla e argumentimit	22
	Përgjegjësi	26
	Fuqia e argumentit më të mirë	27
	Raportet e trupave të pavarura dhe rregullatore	28
V.	RESPEKT, NDËRPRERJE DHE KUFIZIME	31
	Raporti ndaj argumenteve dhe personalitetit të deputetëve nga parti tjetër	31
	Raporti ndaj argumenteve dhe personalitetit sipas llojit të pjesëmarrësve në diskutim	33
VI.	GRUPET E MARGJINALIZUARA NË KUVEND	37
VII.	DEMOGRAFIA E FOLËSVE	41
VIII.	REKOMANDIME	45
IX.	SHTOJCA 1 – INDEKSI I CILËSISË SË DEBATIT	48

IMPRESSUM

Titulli: Vështrim mbi Kuvendin: Raport nga monitorimi i cilësisë së debatit në Kuvend (korrik - dhjetor 2025)

Original title: Поглед на Собрание: Извештај од набљудувањето на квалитетот на дебатата во Собранието (јули – декември 2026): Извештај од набљудување бр. 1/2026

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Autorë: Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq dhe Joana Treneska

Redaktor: Marko Troshanovski

Dizajni: Dejan Kuzmanovski

Shtypshkronja: Rojal Art

Vendi dhe viti i botimit

Shkup, shkurt 2026

I. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Cilësia e debatit në Kuvend është analizuar me përdorimin e «Indeksit të Cilësisë së Debatit». Indeksi është instrument që lejon secili akt individual i fjalës në seancën e monitoruar të kodohet sipas disa karakteristikave kryesore:

- shkalla e argumentimit të fjalimit (sa argumente ka në secilin diskutim);
- shkalla e respektit të folësit ndaj deputetëve të tjerë dhe argumentet e tyre;
- hapja për pranimin e argumenteve të huaja dhe ndryshimi i qëndrimeve individuale për shkak të argumenteve më cilësore të paraqitura në debat;
- mundësi që deputetët të shprehin pa pengesa pikëpamjet e tyre.

Në Raportet gjysmë-vjetore mbi monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend gjithashtu përfshihet edhe nota e përgjithshme e cilësisë së debatit sipas Indeksit të cilësisë së debatit - Discourse Quality Index (DQI). Ky indeks jep notën mesatare prej 1 deri në 10 për cilësinë e debatit në Kuvend.

Me këtë indeks përfshihen shkalla e arsytimit (20% të notës), përfshirja e arsytimit (5%), përgjegjësia (20%), forca e argumentit më të mirë (20%), raporti ndaj pjesëmarrësve të partisë tjetër (10%), raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve nga parti tjetër (10%), raporti ndaj pjesëmarrësve të jashtëm (2,5%), raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm (2,5%), ndërprerje (5%) dhe kufizim (5%) si indikatorë.

Një (1), si nota më e ulët do të thotë se deputetët nuk përdorin asnjë argument gjatë fjalimeve të tyre, nuk u referohen parimeve të caktuara, i shtrembërojnë argumentet, nuk ndryshojnë pozicionin e tyre dhe nuk pranojnë argumente, nuk kanë referencë ndaj argumenteve të tjerëve ose kanë ndryshim të qëndrimit, por jo për shkak të argumenteve të tjetrit. Nota një (1) gjithashtu do të thotë që deputetët tregojnë mosrespektim ndaj pjesëmarrësve të tjerë dhe argumenteve të tyre (deputetë ose pjesëmarrës të jashtëm), se ka ndërprerje të diskutimit dhe se në një moment ka pasur ndërprerje fizike të folësve. Nga ana tjetër, nota dhjetë (10), që do të thotë se cilësia e debatit është e shkëlqyeshme, do të thotë që deputetët përdorin më shumë se dy argumente, ose të paktën një argument gjatë fjalimeve të tyre, i referohen parimeve të caktuara, adresojnë argumentet në përputhje me rrethanat, ka ndryshim të qëndrimit për shkak të argumenteve më të mira, tregojnë respekt për personin dhe argumentet e pjesëmarrësve të tjerë në diskutim (deputetë ose pjesëmarrës të jashtëm), nuk ka ndërprerje të diskutimit dhe nuk ka asnjë kufizim të së drejtës për fjalë.

Më shumë detaje rreth metodologjisë dhe vlerësimit, në Shtojcën 1.

II. HYRJE DHE KONTEKSTI I POLITIKAVE

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka pushtet legjislativ dhe në këtë mandat përbëhet nga 120 deputetë. Deputetët zgjidhen me zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave zgjedhore proporcionale për mandat prej katër vjet. Përbërja aktuale parlamentare që është objektivi i këtij raporti monitorimi u votua në zgjedhjet e njëmbëdhjeta parlamentare më 8 maj 2024. Zgjedhjet u zhvilluan në një atmosferë të drejtë dhe demokratike, pa parregullsi të konsiderueshme. 17 subjekte politike morën pjesë, ndërkaq një fitore bindëse u arrit nga VMRO-DPMNE¹ dhe koalicioni «Maqedonia juaj» me 58 mandate. Koalicioni «Për një të ardhme evropiane» i udhëhequr nga LSDM-ja², fitoi 18 mandate, koalicioni «Fronti Evropian» i udhëhequr nga BDI-ja³ - 18, koalicioni «Vlen» - 14, Levica - 6, dhe partia politike Lëvizja e sapoformuar që NJOH për Maqedoninë tonë - 6. Shumica e re parlamentare numëronte 78 deputetë (VMRO-DPMNE, «Vlen» dhe ZNAM), ndërsa opozita numëronte 42 (LSDM, BDI dhe Levica).

Pas gati një viti nga konstituimi i përbërjes së re parlamentare, Arben Taravari, kreu i një krahu të Aleancës për Shqiptarët (AA), njoftoi pjesëmarrje të pavarur të partisë jashtë koalicionit «Vlen» në zgjedhjet e ardhshme lokale që do të mbahen në vjeshtën e vitit 2025. Menjëherë pas marrjes së vendimit, drejtuesit e tjerë të «Vlen» njoftuan bashkimin e të gjithë anëtarëve të koalicionit në një strukturë të vetme politike, duke krijuar organe të përbashkëta dhe të unifikuara në zgjedhjet lokale.⁴ Megjithatë, unifikimi i shpallur nuk ndodhi deri në vjeshtën e vitit 2025, kështu që në zgjedhjet lokale VLEN përsëri veprroi si koalicion. Ndryshimet e papritura në bllokun politik shqiptar ngritën pyetje në lidhje me përbërjen e shumicës parlamentare. Më 12 maj, Taravari njoftoi zyrtarisht tërheqjen e partisë nga qeveria dhe nga koalicioni «Vlen», duke theksuar se shkak për këtë janë premtimet e pa përmbushura ndaj votuesve të tyre.⁵ Situata politike dhe sociale në vend u destabilizua në mënyrë plotëse më 16 mars 2025, pas zjarrit katastrofik në një diskotekë në Koçan, i cili vrau tragjikisht 62 të rinj dhe lëndoi mbi 190 të tjerë.⁶ Tragjedia, e cila ndodhi si rezultat i shkeljeve të rënda ligjore dhe mosrespektimit të rregullave të sigurisë në nivel lokal dhe shtetëror, ngriti shqetësime publike në lidhje me përhapjen e korrupsionit dhe efektivitetin e mekanizmave të sigurisë institucionale. Si përgjigje fillestare ndaj tragjedisë, Kuvendi vendosi të anulojë të gjitha seancat në dy javët e ardhshme

1 Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)

2 Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM)

3 Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)

4 «Koalicioni Vlen transformohet në një parti të re», Vecer Pres, 21 prill 2025, <https://www.vecer.press/koalicizija-ta-vlen-se-transformira-vo-edna-partija/>

5 «Aleanca për Shqiptarët e Taravarit shkon në opozitë», Radio Evropa e Lirë, 12 maj 2025 <https://www.slobodnaevropa.mk/a/alijansata-za-albancite-na-taravari-odi-vo-opozicija/33411807.html>

6 «Pikëllim kolektiv dhe traumë pas tragjedisë në Koçan», Radio Evropa e Lirë, 18 mars 2025, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/taga-trauma-kocani-zrtvi-/33351579.html>

në mënyrë që të mos nxisë më tej atmosferën tashmë të tensionuar dhe tragjike.⁷ Vendimi për pauzë në kohë krize u prit me shumë kritika nga publiku, ndërkaq një ish kryetar i Kuvendit e përshkroi si pranim të mosfunksionimit të institucionit.⁸ Nga ana tjetër, zyrat lokale të deputetëve në atë rajon u aktivizuan menjëherë pas tragjedisë, ku qytetarët mund t'u drejtoheshin disa prej deputetëve nga njësia zgjedhore 3. Pas një pushimi dy javor, Kuvendi mori masa konkrete ligjore: ndaloi piroteknikën në hapësirat e mbyllura publike dhe vendosi rregullore për objektet hotelierike që pengojnë punën e shërbimeve të urgjencës. Deputetët nuk arritën të kryejnë rolin e tyre mbikëqyrës mbi tragjedinë, përkatësisht më 4 qershor 2025, përpjekja e dytë e grupit parlamentar të Partisë Levica për të thirrur një debat mbikëqyrës dështoi, pasi nuk kishte mbështetje nga shumica qeverisëse. Deputeti dhe Kryetari i Levicës, Dimitar Apasiev, ngriti padi në Gjykatën Administrative kundër Kuvendit dhe Kryetarit të Kuvendit për anulim jo të vullnetshëm dhe të paligjshëm të debatit të planifikuar mbikëqyrës.⁹

Në gjysmën e parë të vitit 2025, fokusi i publikut u zhvendos në Agjendën e shpallur të Reformave të Qeverisë si pjesë e fazës së re të procesit të integritimit evropian dhe të ashtuquajturit "Plani për rritje" i Bashkimit Evropian. Duke pasur parasysh se këto reforma kërkojnë një kapacitet të fortë demokratik, komunikim transparent dhe debat konstruktiv parlamentar, ekziston një nevojë në rritje për një rol aktiv dhe të përgjegjshëm të Kuvendit në procesin e mbikëqyrjes, krijimit të politikave dhe përfshirjes së publikut. Lidhur me parakushtin e vendosur nga Bullgaria për zhbllokimin e procesit të integritimit evropian, Komisionerja për Zgjerim Marta Kos përsëriti gjatë samitit të BE-së narrativën se të dy vendet duhet të vazhdojnë bashkëpunimin dhe Maqedonia e Veriut të zbatojë ndryshimet kushtetuese në mënyrë që të përfitojë nga dritarja e hapur kohët e fundit për zgjerimin e Bashkimit.¹⁰

Zgjedhjet lokale të vitit 2025 (raundi i parë i 19 tetorit dhe raundi i dytë i 2 nëntorit) u mbajtën në një kontekst të ndjeshmërisë së shtuar politike dhe pasigurisë ligjore, me ndryshime të vonshme në legjisllacionin zgjedhor që kanë potencialin të ndikojnë në shfaqjen e listave zgjedhore dhe rezultatin zgjedhor, veçanërisht rreth kandidatëve të pavarur dhe përfaqësimit mediatic. Boshllëqet ligjore, qasja e pabarabartë në media dhe rregullat e rrepta të fushatës kanë krijuar një avantazh strukturor për partitë më të mëdha dhe kanë kufizuar shikueshmërinë e aktorëve më të vegjël dhe të pavarur, pavarësisht një numri rekord të kandidaturave të tyre. Në të njëjtën kohë, zgjedhjet u shënuan nga një rënie e qartë e pjesëmarrjes dhe një numër rekord i fletëve të pavlefshme të votimit, që sugjeron lodhje politike në rritje, besim të ulët në institucione dhe protestë të heshtur. Në këto zgjedhje, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi numrin më të madh të komunave, duke siguruar 33 fitore për kryetar komune në raundin e parë dhe 21 fitore shtesë për kryetar komune në raundin e dytë, si dhe funksionin e kryetarit të komunës në Qytetin e Shkupit, gjithsej 54 komuna plus kryeqytetin. Koalicioni

7 "Kuvendi anuloi të gjitha aktivitetet edhe këtë javë", Sitel TV, 25 mars 2025, <https://sitel.com.mk/sobraniето-gi-ot-kazha-site-aktivnosti-i-ovaa-nedela>

8 "Petkovski: Kuvendi të shpërndahet, në momentin më të vështirë që i ka lënë qytetarët", Free Press, 25 mars 2025, <https://www.slobodenpecat.mk/petkovski-sobraniето-da-se-samoraspushti-vo-najteshkiot-moment-gi-napush-ti-gragjanite/>

9 "Apasiev do të padisë Gashin dhe Kuvendin për debatin mbikëqyrës mbi Koçanin," Slobodenn Peçat, 28 korrik 2025, <https://www.slobodenpecat.mk/apasiev-kje-gi-tuzhi-gashi-i-sobraniето-poradi-nadzornata-rasprava-za-kochani/>

10 "Samiti në Shkup – Zgjerimi mund të bashkojë Evropën", 1 korrik 2025, <https://www.dw.com/mk/kos-clenstvo-to-vo-eu-e-najdobar-nacin-da-se-zastiti-identitetot/a-73099991>

VLEN arriti gjithsej 9 fitore – 5 në raundin e parë dhe 4 në raundin e dytë, koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi nga 3 komuna në secilin raund zgjedhor, gjithsej 6, koalicioni i udhëhequr nga BDI fitoi 3 komuna në raundin e parë dhe një në raundin e dytë, gjithsej 4, ndërsa partitë ZNAM dhe Unioni i Romëve fituan nga një komunë secila, të dyja në raundin e dytë, duke ruajtur një prezencë lokale të kufizuar. Në raundin e dytë u zgjodh edhe një kandidat i pavarur.

Në nëntor, filluan procedurat gjyqësore në lidhje me zjarrin katastrofik në Koçan, i cili ishte një provë kryesore e aftësisë së prokurorisë dhe gjyqësorit për të vepruar në një rast me interes të lartë publik. Mënyra se si u formuluan akuzat, përfshirja e personave të dyshuar dhe dinamika e procesit gjyqësor hapën një debat publik mbi atë nëse hetimi do të rezultojë në përcaktimin e plotë të përgjegjësisë individuale dhe institucionale. Përveç procesit gjyqësor, tragjedia ishte e pranishme edhe në dhomën legjislative, përmes punës së Komisionit të Përhershëm Anketues për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të njeriut, i cili në dhjetor 2025 mbajti një seancë të dedikuar për rastin. Debati u karakterizua nga polemika të ashpra mes deputetëve dhe fjalime të drejtpërdrejta nga familjet e viktimave, të cilat kërkuan drejtësi, përgjegjësi institucionale dhe identifikimin e mangësive sistemike që çuan në tragjedi.

Në dhjetor 2025, prokurori shtetëror Ljupço Kocevski dha dorëheqje të parevokueshme menjëherë para hapjes së procedurës për shkarkimin e tij në Kuvend, duke deklaruar se kundër tij po zhvillohej një proces me motive politike dhe se këto procedura përbënin një kërcënim serioz për pavarësinë e prokurorisë dhe për parimet e sundimit të ligjit. Dorëheqja, e cila ndërpreu mundësinë e një debati parlamentar për shkarkimin e tij, forcoi më tej perceptimin e një krize institucionale dhe mosbesimin në aftësinë e sistemit për të siguruar llogaridhënie pa ndikime politike

III. REZYME

Vlerësimi për cilësinë e debatit për periudhën korrik – dhjetor 2025, në shkallën nga 1 deri në 10, është 5.7, që është në të njëjtin nivel me cilësinë e debatit në gjysmën e parë të vitit 2025. Duke pasur parasysh se cilësia e debatit gjatë shtatë muajve të parë të kësaj përbërje parlamentare (qershor – dhjetor 2024) u vlerësua me 5.5, mund të përfundohen një përmirësim i lehtë në cilësinë e debatit dhe ruajtja e këtij niveli. Megjithatë, dallimi është relativisht modest dhe sugjeron që sfidat strukturore dhe përmbajtësore në debatin parlamentar janë ende të pranishme.

Aktiviteti i deputetëve u monitorua sipas asaj se sa shpesh janë paraqitur për një fjalë dhe sa minuta kanë qëndruar në foltoren e parlamentit. Në mesin e deputetëve që më shpesh janë paraqitur për fjalë janë shtatë deputetë nga opozita dhe tre deputetë nga pushteti. Sa i përket kohës që deputetët qëndruan në foltore, në dhjetëshen e parë ishin tetë deputetë nga opozita dhe dy nga shumica. Deputetët që qëndruan më gjatë në foltoren e Kuvendit ishin Salli Murati, Fatmir Bytyqi dhe Jovanka Trençevska. Midis dhjetë deputetëve që më shpesh merrnin fjalën dhe/ose qëndronin më gjatë në foltore gjatë kësaj periudhe të vëzhgimit ka katër gra dhe shtatë burra.

Në 21% të diskutimeve të analizuara, pjesëmarrësit në debatin parlamentar nuk kishin argumente, ndërsa në 49% të diskutimeve të analizuara kishin argumentim të dobët, përkatësisht folësit ofruan arsyetim të pozicioneve të tyre, që nuk është i mjaftueshëm për tu konsideruar si argument i plotë. Në 21% të diskutimeve të monitoruara folësit përdorën të paktën një argument për të shpjeguar pozicionin e tyre. Niveli i argumentimit në vitin 2025 shënoi një përmirësim të lehtë në krahasim me gjysmën e dytë të vitit 2024 dhe 2023. Nëse analizohet niveli i argumentimit në fjalimet sipas llojit të tyre, vihet re se argumentimi është dukshëm më i ulët në replikat dhe kontra-replikat krahasuar me fjalimet, gjë që kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në mesataren e ulët të vlerësimit të cilësisë së debatit në Kuvend.

Në lidhje me atë se si deputetët i përgjigjen argumenteve të bëra nga folës të tjerë, monitorimi vëren se vetëm në 10% të fjalimeve të tyre, deputetët i kanë adresuar në mënyrë përkatëse argumentet, përkatësisht deputeti / deputetja drejtpërdrejtë i është përgjigjur argumenteve të cilat paraprakisht i ka adresuar pjesëmarrës tjetër në diskutim. Për dallim nga periudhat e mëparshme të vëzhgimit, në të cilat është regjistruar një tendencë e vazhdueshme e përmirësimit, në këtë periudhë është vërejtur përqindja më e ulët e adresimit të argumenteve në mënyrë adekuate.

Në periudhën korrik – dhjetor 2025, deputetët në shumicën e fjalimeve të tyre nuk iu referuan as argumenteve të bashkëbiseduesit nga një opion tjetër politik¹¹ (78%), as personalitetit të tyre (78%)¹². Kjo marrëdhënie është pothuajse në të njëjtin nivel me periudhën e mëparshme të vëzhgimit. Gjatë kësaj periudhe është vëzhguar shqyrtimi i 4 raporteve¹³ nga trupat e pavarura dhe rregullatore të dorëzuara në Kuvend. Për 1 raporte nuk u diskutua, ndërsa për 3 raporte diskutimi ishte dukshëm i shkurtër, që do të thotë se në ndarjen e pjesëve të rolit mbikëqyrës të Kuvendit mungonte dukshëm një nivel i caktuar kontrolli.

Gjatë periudhës së monitorimit u mbajtën tre seanca të rregullta dhe dy seanca shtesë të pyetjeve të deputetëve për opozitën. Pyetjet e rregullta parlamentare për muajin shtator dhe tetor nuk u realizuan për shkak të vendimit të deputetëve për të mos u takuar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale.

Raporti konfirmon edhe vëmendjen vazhdimisht të ulët të deputetëve për të drejtat e grupeve të marginalizuara, gjatë të gjitha periudhave të monitorimit. Është vërejtur se deputetët në 79% të diskutimit të tyre, që është njëfarë përmirësimi nga periudha e kaluar kur përqindja arriti në 87%. Është vërejtur se deputetët në pjesën më të madhe të fjalimeve të tyre nuk adresojnë të drejtat e grupeve të marginalizuara përveç nëse diskutohet specifikisht për ligj konkret ose temë në rend të ditës, në lidhje me të drejtat e tyre.

Rekomandime për përmirësimin e cilësisë së debatit parlamentar:

- Të rritet cilësia dhe argumentimi i debatit parlamentar duke rritur në mënyrë sistematike përgatitjen dhe fjalimet e deputetëve.
- Të forcohen njohuritë, si dhe aftësitë debatimore dhe oratorike të deputetëve përmes trajnimit dhe edukimit të vazhdueshëm, duke siguruar mbështetje sistematike për deputetët e sapozgjedhur, me fokus të veçantë në paraqitjen e argumentuar dhe përdorimin efektiv të mjeteve analitike në dispozicion.
- Të përdoren më intensivisht dhe më në mënyrë efektive shërbimet, analizat dhe hulumtimet e Institutit Parlamentar dhe Zyrës Parlamentare të Buxhetit.

11 Termi "opcion politik" i referohet një partie politike ose koalicioni, të kategorizuar në mënyrë të qartë si shumicë qeverisëse ose opozitë. Shumica përfaqëson deputetët, të cilët partitë ose koalicionet e tyre formojnë Qeverinë dhe kanë shumicë parlamentare, ndërsa opozita përfaqëson deputetët, të cilët partitë ose koalicionet e tyre nuk janë në pushtet.

12 Termi "person" i referohet karakteristikave personale të folësit, të tilla si karakteri, motivet ose prejardhja e tij, në vend të përmbajtjes së argumenteve të tij.

13 Raporti vjetor për auditimet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror për Revizion për vitin 2024 (diskutim i vëzhguar në seancën plenare nr. 68, të mbajtur më 12 shtator 2025) – pa diskutim; Raporti vjetor për punën e Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së Fëmijëve dhe Drejtësinë për Fëmijë për gjendjet në fushën e të drejtave të fëmijës dhe delikuencës së fëmijëve për vitin 2024 (diskutim i vëzhguar në seancën plenare nr. 68, të mbajtur më 12 shtator 2025) – diskutim i dobët; Raporti vjetor për vitin 2022 dhe 2023 për zbatimin e Strategjisë për Barazi Gjinore 2022–2027 dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore 2022–2024 (diskutim i vëzhguar në Komisionin për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave nr. 10, të mbajtur më 25 dhjetor 2025) – diskutim i dobët; Raporti vjetor për punën e Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimit Pensional me Financim Kapital për vitin 2024 dhe raportet financiare për vitin 2024 (diskutim i vëzhguar në seancën plenare nr. 68, të mbajtur më 1 shtator 2025) – diskutim i dobët.

- Të vendoset dhe të zbatohet në mënyrë aktive Vlerësimi i Ndikimit të Rregullativës (VNR) në punën e Kuvendit, duke përfshirë edhe projektligjet e paraqitura nga deputetët.
- Të kufizohet përdorimi i procedurës së shkurtuar dhe i procedurës me flamurin evropian.
- Të forcohet roli mbikëqyrës i Kuvendit përmes ndjekjes dhe vlerësimit më aktiv të politikave strategjike dhe proceseve reformuese të Qeverisë.
- Të inkurajohet pjesëmarrja më e madhe e qytetarëve, sektorit joqeveritar dhe publikut ekspert në procesin legjislativ, përfshirë edhe përmes debateve publike legjislative.
- Të inkurajohet përdorimi i shembujve nga përvojat, interesat dhe nevojat e qytetarëve në debatet parlamentare dhe të reagojë në mënyrë aktive ndaj fjalimeve diskriminuese dhe seksiste.
- Të zbatohet një kalendar i seancave plenare dhe të komisioneve me qëllim rritjen e parashikueshmërisë, përgatitje më të mirë dhe debat parlamentar më cilësor

IV.

CILËSIA E DEBATIT



IV. CILËSIA E DEBATIT

■ NOTA PËR CILËSINË E DEBATIT

Përbërja aktuale parlamentare u zgjodh në zgjedhjet parlamentare të mbajtura në maj 2024. Që atëherë, janë përgatitur tre analiza për cilësinë e debatit në lidhje me këtë përbërje: e para mbulon periudhën qershor-dhjetor 2024, përkatësisht shtatë muajt e parë të mandatit të tyre, e dyta mbulon periudhën janar-qershor 2025, dhe e treta, përkatësisht kjo analizë, mbulon semestrin e dytë të vitit 2025, korrik-dhjetor. Analizat e përgatitura para këtyre tre periudhave të përmendura i referohen përbërjeve parlamentare të mëparshme.

Cilësia e debatit u vlerësua me 5,7 (nga 1 deri në 10), që përbën një përmirësim të vogël krahasuar me gjysmën e parë të mandatit të kësaj përbërje parlamentare (qershor – dhjetor 2024), kur vlerësimi ishte 5,5

Vlerësimi për cilësinë e debatit për periudhën korrik – dhjetor 2025, në shkallën nga 1 deri në 10, është 5.7, që është në të njëjtin nivel me cilësinë e debatit në gjysmën e parë të vitit 2025. Duke pasur parasysh se cilësia e debatit gjatë shtatë muajve të parë të kësaj përbërje parlamentare (qershor – dhjetor 2024) u vlerësua me 5.5, mund të përfundohen një përmirësim i lehtë në cilësinë e debatit dhe ruajtja e këtij niveli. Megjithatë, dallimi është relativisht modest dhe sugjeron që sfidat strukturore dhe përmbajtësore në debatin parlamentar janë ende të pranishme

**VLERËSIMI I CILËSISË SË DEBATIT PËR
PERIUDHËN KORRIK-DHJETOR 2025,
NË SHKALLËN NGA 1 DERI NË 10**



Me notën 5.7, diskutimi në Kuvend ende nuk arrin notën minimale të nevojshme për t'u konsideruar një debat i shëndetshëm, veçanërisht duke pasur parasysh rezultatet e dobëta në aspektin e hapjes për pranimin e argumenteve të të tjerëve, gatishmërinë për të ndryshuar pikëpamjet e tyre për shkak të argumenteve të paraqitura në debat dhe shkallën e ulët të mbështetjes argumentuese për pikëpamjet e shprehura. Në përgjithësi, cilësia e debatit, pavarësisht nga përmirësimi i lehtë, mbetet ende në nivel të ulët me hapësirë të konsiderueshme për përmirësim.

■ LLOJI I DISKUTIMEVE

Këtë periudhë (qershor – dhjetor 2025) 21% e diskutimeve të monitoruara ishin pjesë e seancave plenare, 65% ishin seanca të komisioneve¹⁴, 11% ishin pjesë e pyetjeve të deputetëve dhe 2.5% ishin debate publike. Janë monitoruara gjithsej 1412 diskutime individuale ose fjalime të deputetëve dhe pjesëmarrësve të jashtëm¹⁵ në debat. Në gjysmën e dytë të vitit 2025, u mbajtën gjithsej tre seanca të rregullta të pyetjeve deputetëve dhe dy seanca shtesë parlamentare për pyetje të deputetëve të rezervuara për opozitën. Seancat për pyetje të deputetëve për muajin shtator dhe tetor 2025 nuk u mbajtën për shkak të vendimit të Kuvendit për të mos u takuar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të mbajtura më 19 tetor (raundi i parë) dhe 2 nëntor (raundi i dytë) 2025. Nga aktet e monitoruara, 92% u zbatuan në procedurë normale, 7% me procedurë të shkurtuar, ndërsa 1% e akteve të monitoruara në Kuvend u shqyrtuan me flamur Evropian.

Temat më të debatuar në këtë periudhë vëzhgimi ishin Propozimi për Buxhetin e shtetit për vitin 2026, si dhe Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit për vitin 2025. Deputetët gjithashtu i kushtuan kohë të konsiderueshme debatit mbi propozim-ligjin për Këshillin Gjyqësor, propozim-ligjin për institucionet e arsimit të mesëm të komuniteteve fetare, raportin e Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2025, debatit publik me temë «Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve nga ndikimet dhe pasojat e dëmshme të duhanit», propozim-ligjit për lëshimin e kuponëve të vlefshëm dhe propozim-ligjit për punët e brendshme.

14 Komisionet e vëzhguara Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet bashkësive, Komisioni për Çështje Evropiane, Komisioni për Financim dhe Buxhet, Komisioni për Çështje të Rregullores Mandatit dhe Imunitetit, Komisioni për Çështje Ekonomike, Punë dhe Politikë Energjie Komisioni për Shëndetësi, Komisioni për Vetëqeverisje Lokale, Komisioni për Politikë të Jashtme dhe Tregti të Jashtme, Komisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masave për Monitorimin e Komunikimeve, Komisioni për Arsimin, Shkencë dhe Sport, Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve, Komisioni për Politika Sociale, Demografi dhe Rini, Komisioni për Transport, Transformim Digjital, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarëve, Këshilli Kombëtar për Eurointegritim.

15 Si pjesëmarrës të jashtëm në diskutimin në Kuvend konsiderohen të gjithë folësit në seancat plenare dhe komisionet që nuk mbajnë statusin e deputetit, por kanë të drejtë të marrin pjesë në debatin parlamentar, siç janë Kryeministri, ministrat, përfaqësuesit e trupave rregullatore dhe agjencitë etj.


Sipas përkatësisë politike të deputetëve folës nga monitorimi në këtë periudhë, rezulton se deputetët e shumicës të përbërë nga koalicioni «Maqedonia juaj» i udhëhequr nga VRMO – DPMNE, koalicioni «Vlen» dhe lëvizja që ZNAM– morën pjesë në 37% të diskutimeve të monitoruara, ndërsa opozita e përbërë nga koalicioni «Për një të ardhme evropiane» i udhëhequr nga LSDM-ja, koalicioni «Fronti Evropian» i udhëhequr nga BDI-ja dhe partia E Majta morën pjesë në 63% të diskutimeve të monitoruara.

Grafiku 1. Përkatësia politike e deputetëve folës (%)




Në mesin e deputetëve që më shpesh janë paraqitur për fjalë janë shtatë deputetë nga opozita dhe tre deputetë nga pushteti. Sa i përket kohës që deputetët qëndruan në foltore, në dhjetëshen e parë ishin tetë deputetë nga opozita dhe dy nga shumica. Tre deputetët që qëndruan në foltoren e parlamentit më së gjati dhe më së shumti herë kërkuan fjalë janë Sali Murati, i cili ka folur 433 minuta, ndërsa për fjalë është paraqitur 76 herë, Fatmir Bytyqi, i cili ka folur 336 minuta, ndërsa për fjalë është paraqitur 74 herë dhe Jovanka Trençevska, e cila ka folur 285 minuta, dhe për fjalë është paraqitur 68 herë. Midis dhjetë deputetëve që më shpesh kanë marrë fjalën dhe/ose kanë qëndruar më gjatë në foltore gjatë kësaj periudhe të vëzhgimit janë katër deputete: Jovanka Trençevska, Daniella Nikollova, Dragana Bojkoska dhe Sanja Llukarevska, dhe shtatë deputetë: Sali Murati, Fatmir Bytyqi, Ljupço Prençov, Bojan Stojanoski, Halil Snopçe, Oliver Spasovski dhe Rexhep Ismail. ►

► Grafiku 2. Deputetët që kanë qëndruar më gjatë në foltore gjatë periudhës korrik-dhjetor 2025.



■ Sa minuta ka folur gjithsej

Grafiku 3.16 Deputetët që më shpesh kanë marrë fjalën në Kuvend gjatë periudhës korrik-dhjetor 2025.




■ Sa herë është paraqitur për fjalë

16 Grafiku përshkruan se cilët deputetë/deputete ishin më aktivë nga gjithsej 1,412 diskutime ose fjalime të veçanta të deputetëve të vëzhguara në periudhën Korrik-Dhjetor 2025.

Sipas llojit të diskutimeve të vëzhguara në këtë periudhë, shumica e diskutimeve janë fjalime (61%), ndërsa 22% e diskutimeve janë replika, 16% kundër replika dhe 1% vërejtje procedurale. Edhe pse krahasuar me periudhën e kaluar të vëzhgimit, ka një rënie të lehtë të përqindjes së fjalimeve në favor të përqindjes së replikave dhe kundërreplikave, megjithatë kjo situatë tregon një nivel relativisht të ulët të ndërveprimit midis deputetëve. Kështu, në pjesën më të madhe të debatit fokusi është në transmetimin njëanshëm të qëndrimeve, të cilat shpesh nuk gjejnë pranues nga ana tjetër, përkatësisht mbeten pa replika dhe pa mbështetje të veçantë ose kundërshtim nga deputetët e tjerë. Kjo tendencë vihet re nga ndryshimi i përbërjes parlamentare pas zgjedhjeve parlamentare.

Me 61% pjesëmarrje në fjalime nga totali i diskutimeve, debati parlamentar vazhdon të zhvillohet kryesisht si një transmetim njëanshëm i qëndrimeve, me ndërveprim të kufizuar dhe shkëmbim të dobët të qëndrimeve midis deputetëve.


Grafiku 4. Lloji i diskutimit (%)?



Duke iu referuar llojit të diskutimit sipas përkatësisë politike të folësve, mund të vërehet se shumica e diskutimit inicohet nga shumica parlamentare, përmes fjalimeve të tyre (67%) për pikat e rendit të ditës, si dhe përmes një pjese të madhe të kundër replikave (61%). Për dallim nga shtatë muajt e parë të mandatit të kësaj përbërjeje parlamentare (korrik - dhjetor 2024) kur pjesëmarrja e shumicës dhe opozitës në debatin parlamentar ishte pothuajse e barabartë, në vitin 2025 vërehet se opozita është dukshëm më e pranishme në foltoren parlamentare.

Edhe pse në gjysmën e dytë të vitit 2024 kishte një barazi më të madhe në debat, të dhënat nga viti 2025 tregojnë se shpërndarja e fjalimeve dhe përgjigjeve është dukshëm e pabarabartë. Kjo tregon se tendenca e barazisë më të madhe të vërejtur në vitin 2024 nuk ka vazhduar dhe se ndryshimi në përbërjen parlamentare nuk ka rezultuar në një ndryshim të qëndrueshëm pozitiv në cilësinë e debatit.

Grafiku 4.1 Lloji i diskutimit sipas përkatësisë politike (%)




Kuvendi votoi më 20 nëntor 2023 për Rregulloren e re të punës së dhomës ligjvënëse që do të zbatohet nga përbërja e re parlamentare e cila do të formohet pas zgjedhjeve të majit 2024. Rregullorja e re, përveç pyetjeve të rregullta të deputetëve që realizohen çdo të enjte të muajit, parashikon pyetje shtesë të deputetëve, ku në një seancë të posaçme gjatë muajit në kohëzgjatje prej dy orë, opozita do të ketë mundësi të parashtrijë pyetje.¹⁷ Pyetjet e deputetëve janë mjet i rëndësishëm për mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, por edhe për të kërkuar përgjegjësi prej saj. Prandaj, është thelbësore që Kuvendi të organizojë në mënyrë konsekuente seancat për pyetje deputetësh.

Në këtë periudhë monitorimi, korrik-dhjetor 2025, u mbajtën pesë seanca të pyetjeve të deputetëve, nga të cilat tre seanca të rregullta, dhe dy seanca shtesë të pyetjeve të deputetëve për opozitën. Seancat për pyetje të rregullta të deputetëve në shtator dhe tetor 2025 nuk u mbajtën për shkak të vendimit të Kuvendit për të mos u takuar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale.

Lidhur me diskutimin në seancat e pyetjeve të deputetëve të mbuluara nga vëzhgimi, 57% e diskutimit iu kushtua shtrimit të pyetjeve dhe plotësimit të pyetjeve, ndërsa pjesa tjetër e diskutimit iu kushtua përgjigjeve të pyetjeve të deputetëve (43%) nga përfaqësuesit e Qeverisë. Krahasuar me seancat e pyetjeve të deputetëve që u mbajtën në periudhën e kaluar me përbërjen e re parlamentare dhe ato të mbajtura me përbërjen e kaluar parlamentare, mund të theksohet se ky raport është paralel me praktikën në periudhat e mëparshme të monitorimit.

¹⁷ Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qasur përmes: <<https://shorturl.at/ht0cU>>

Grafiku 5. Seanca për pyetje të deputetëve (%)




■ SHKALLA E ARGUMENTIMIT

Argumentet, sipas metodologjisë që zhvilloi Instituti për Demokraci për monitorimin e cilësisë së debatit në Kuvend, përkufizohen si një përpjekje e arsyeshme (e arsyetuar) për të bindur publikun të pranojë një këndvështrim të caktuar për një tezë të diskutueshme. Prandaj, argumenti perceptohet si arsyeja pse deputetët mbështesin ose kontestojnë një tezë të caktuar. Fjalim i argumentuar konsiderohet të jetë fjalimi që përmban një pohim - titulli i argumentit, një fjali e cila pohon ose mohon një pikë në rend të ditës; shpjegim - sqarimi dhe lidhja e pretendimit dhe thelbit të tij, përkatësisht zbërthimi dhe depërtimi në thelbin e argumentit dhe çështjes dhe si do të ndikojë dhe provave - me atë që argumenti do të ishte vetëm një frazë e zbrazët nëse nuk ka ndonjë provë të vlefshme dhe të fortë.

Bazuar në këto kritere të përcaktuara, në 30% të diskutimeve të analizuara, pjesëmarrësit nuk kishin argumente, ndërsa në 49% të diskutimeve të analizuara kishin argumentim të dobët, përkatësisht folësit ofruan arsyetim të pozicioneve të tyre, që nuk është i mjaftueshëm që të konsiderohet si një argumentim i plotë. Në 21% të diskutimeve të monitoruara folësit përdorën të paktën një argument për të shpjeguar pozicionin e tyre. Niveli i argumentimit në përbërjen e re parlamentare në vitin 2025 shënon përmirësim në krahasim me gjysmë vjetorin e parë të mandatit të tyre, dhe është dukshëm më i mirë se gjysmë vjetori i dytë i vitit 2023, kur Kuvendi kishte përbërjen e mëparshme parlamentare.

Në 21% të diskutimeve të vëzhguara, deputetët përdorin të paktën një argument për të arsyetuar qëndrimet e tyre, gjë që tregon një përmirësim të dukshëm të nivelit të argumentimit krahasuar me përbërjen parlamentare të mëparshme dhe periudhën fillestare të mandatit.


Grafiku 6. Shkalla e argumentimit (%)



Nëse analizojmë shkallën e argumentimit të fjalimeve sipas llojit të fjalimeve në diskutim, mund të vërejmë se argumentimi është dukshëm i ulët në replikat dhe kundër replikat, krahasuar me fjalimet. Kështu, vetëm 14% e fjalimeve vlerësohen si të pa argumentuara, në krahasim me 39% të replikave dhe 59% të kundër replikave. Një nivel kaq i ulët i argumentimit në këto lloje të fjalimeve, kontribuon ndjeshëm në vlerësimin mesatar të cilësisë së debatit në Kuvend. Nga ana tjetër, një e treta (33%) e fjalimeve justifikohen me të paktën një argument, në krahasim me 6% të replikave dhe 3% të kundër replikave.

Niveli i ulët i argumentimit në replikat dhe kundër-replikat kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në mesataren e ulët të vlerësimit të cilësisë së debatit në Kuvend.

Grafiku 6.1 Niveli i argumentimit të diskutimeve sipas llojit të fjalimit (%)




Nëse e konsiderojmë argumentimin e debatit në Kuvend bazuar në llojin e folësit – deputet ose pjesëmarrës i jashtëm, nga numri i përgjithshëm i fjalimeve të vëzhguara të deputetëve dhe pjesëmarrësve të jashtëm në diskutim, 76% u përkasin deputetëve, ndërsa 24% u përkasin pjesëmarrësve të jashtëm. Pjesëmarrës të jashtëm janë të gjithë folësit në seancat parlamentare dhe seancat e komisioneve, që nuk mbajnë statusin e deputetit, por kanë të drejtë të marrin pjesë në debatin parlamentar, si për shembull Kryeministri, ministrat, përfaqësuesit e trupave rregullatore dhe agjencive, përfaqësues të organizatave qytetare, etj.

Prandaj, nëse analizojmë shkallën e argumentimit sipas llojit të folësit, mund të vërejmë se pjesëmarrësit e jashtëm përdorin argumente më shpesh sesa deputetët gjatë diskutimeve të tyre. Kështu, 27% e fjalimeve të pjesëmarrësve të jashtëm u vlerësuan si të argumentuara me një argument, në krahasim me 20% të fjalimeve të deputetëve.

Pjesëmarrësit e jashtëm përdorin më shpesh argumente në diskutim, krahasuar me deputetët.


Grafiku 6.2 Shkalla e argumentimit të diskutimeve sipas llojit të pjesëmarrësve në diskutim (%)



Nëse fjalimet e mbajtura nga deputetët analizohen sipas përkatësisë politike të deputetëve, 46% e diskutimit të bërë nga deputetët e pushtetit është argumentuar dobët, ndërsa në 40% nuk është identifikuar asnjë arsye në lidhje me temën e diskutimit në seancë. Në 19% të diskutimeve të shumicës, u identifikua të paktën një argument. Në lidhje me deputetët e opozitës, 50% e fjalimeve karakterizohen nga argumente të dobëta, ndërsa në 27% të diskutimeve të tyre nuk përdoren argumente aspak. Në 23% të diskutimeve të opozitës, u identifikua të paktën një argument.


Argumentimi në fjalime është më i dukshëm te opozita në krahasim me shumicën gjatë kësaj periudhe të vëzhgimit.

Grafiku 7. Shkalla e argumentimit të diskutimeve sipas përkatësisë politike të deputetëve (%)



Analiza më e detajuar tregon se nga numri i përgjithshëm i fjalimeve të vëzhguara të shprehura nga deputetët, të cilat mbështeten nga të paktën një argument, gjysma (49%) janë dorëzuar nga vetëm tetë deputetë. Kështu, 10% e numrit të përgjithshëm të fjalimeve të vëzhguara nga deputetët, të mbështetura nga të paktën një person tjetër, i përkasin Sali Muratit, 9% Jovanka Trençeveskës, nga 7% i përkasin Sonja Mirakovskës dhe Fatmir Bytyqit, 5% Oliver Spasovskit, 4% Bojan Stojanoskit dhe Sanja Lukareskës, dhe 3% i përkasin Rexhep Ismailit.

Grafiku 7.1 Deputetët me pjesëmarrjen më të lartë në numrin total të fjalimeve të deputetëve që mbështeten nga të paktën një argument (%)




■ PËRGJEGJËSI

Në lidhje me atë se si deputetët i përgjigjen argumenteve të bëra nga folës të tjerë, monitorimi vëren se vetëm në 10% të fjalimeve të tyre, deputetët i kanë adresuar në mënyrë përkatëse argumentet, përkatësisht deputeti / deputetja drejtpërdrejtë i është përgjigjur argumenteve të cilat paraprakisht i ka adresuar pjesëmarrës tjetër në diskutim. Për më tepër, në 23% të diskutimit, deputetët pjesërisht iu përgjigjen argumenteve të adresuara ndërsa pjesërisht i shtrembëruan ose i injoruan ato. Në 9% të rasteve argumentet nuk u injoruan, por u shtrembëruan, ndërsa në 7% argumentet e deputetëve të tjerë u injoruan plotësisht. Në 51% të rasteve, nuk ishin adresuar argumente ose pyetje nga deputetë të tjerë, që sugjerojnë nivel të ulët të diskutimit në përgjithësi.

Ndryshe nga periudhat e mëparshme të vëzhgimit, ku u evidentua një trend i vazhdueshëm përmirësimi, në këtë periudhë u shënuan përqindja më e ulët e adresimit të duhur të argumenteve, paralelisht me një rritje të pjesës së fjalimeve në të cilat nuk i referohet fare argumenteve të paraqitura nga folësi tjetër, gjë që tregon përballje të pjesshme dhe shfaqje të një debati paralel.

Në 10% të fjalimeve të tyre, deputetët kanë adresuar në mënyrë të përshtatshme argumentet, përkatësisht deputeti/deputetja është përgjigjur drejtpërdrejt ndaj argumenteve që i ishin drejtuar më parë nga një pjesëmarrës tjetër në diskutim.

Grafiku 8. Përgjegjësia e deputetëve (%)




■ FUQIA E ARGUMENTIT MË TË MIRË

Në këtë periudhë vëzhgimi, në diskutimet e monitoruara, nuk është vërejtur ndryshim i qëndrimit midis deputetëve për shkak të argumenteve më të mira të bashkëbiseduesve, që është në të njëjtin nivel nga përbërja e kaluar parlamentare. Në 64% të diskutimeve, nuk u vërejt asnjë referencë për cilësinë e argumenteve të deputetëve të tjerë, që është për 4 pikë të përqindjes më pak se periudha e mëparshme. Në 5% të diskutimit, deputetë nga opsione të ndryshme politike, megjithëse nuk e ndryshuan pozicionin e tyre, përsëri pranuan cilësinë dhe vlerën e argumenteve të bashkëbiseduesve të tyre nga partitë e tjera.

Në drejtim të respektimit të argumenteve të bashkëbiseduesit, ka pasur një përmirësim të lehtë nga periudha e kaluar. Në 26% të diskutimit, deputetët mbajtën qëndrimin e tyre dhe nuk e pranuan vlerën e argumenteve të folësve nga opsionet e tjera politike.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, në diskutimet e vëzhguara nuk u vërejt ndonjë ndryshim qëndrimi tek deputetët si pasojë e argumenteve më të mira të bashkëbiseduesve.

Grafiku 9. Fuqia e argumentit më të mirë (%)



■ RAPORTET E TRUPAVE TË PAVARURA DHE RREGULLATORE

Nga korriku deri në dhjetor 2025 është monitoruar shqyrtimi i tetë raporteve nga trupat e pavarura dhe rregullatore të dorëzuara në Kuvend. Në pesë raporte nga autoritete të pavarura dhe rregullatore, diskutimi ishte plotësisht i munguar, ndërsa për tre raportet e tjera, debati mund të vlerësohet si i shkurtër dhe i kufizuar.

Shqyrtimi i raporteve nga autoritetet e pavarura dhe rregullatore në Kuvend është jashtëzakonisht i rëndësishëm, pasi siguron më shumë transparencë në punën e ekzekutivit, duke u dhënë qytetarëve një pasqyrë më të qartë mbi veprimtarinë e autoriteteve të pavarura dhe rregullatore.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, në diskutimet e vëzhguara nuk u vërejt ndonjë ndryshim qëndrimi tek deputetët si pasojë e argumenteve më të mira të bashkëbiseduesve.

Tabela 1. Raportet e trupave të pavarura dhe rregullatore të monitoruara në periudhën qershor – dhjetor 2025

1	Raporti vjetor për revizionet e kryera dhe për punën e Entit Shtetëror për revizion për vitin 2024 (diskutimi i vëzhguar në seancë plenare nr. 68, mbajtur më 12 shtator 2025)	3	Raporti vjetor për vitin 2022 dhe 2023 për zbatimin e Strategjisë për Barazi Gjinore 2022-2027 dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore 2022-2024 (Diskutim i vëzhguar i Komisionit për mundësi të barabarta ndërmjet burrave dhe grave nr. 10, mbajtur më 25 dhjetor 2025)
2	Raporti vjetor për punën e Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve dhe të drejtave të fëmijëve për gjendjet në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së të miturve për vitin 2024 (Diskutim i vëzhguar në seancë plenare nr. 68, mbajtur më 12 shtator 2025)	4	Raporti vjetor për punën e Agjencisë për Supervizion të sigurimit Pensional me Financim Kapital në vitin 2024 dhe pasqyrat financiare për vitin 2024 (diskutimi i vëzhguar në seancë plenare nr. 68, mbajtur më 1 shtator 2025)

■ Nuk ka diskutim

■ Diskutim i dobët



**RESPEKT,
NDËRPRERJE DHE
KUFIZIME**



V. RESPEKT, NDËRPRERJE DHE KUFIZIME

■ RAPORTI NDAJ ARGUMENTEVE DHE PERSONALITETIT TË DEPUTETËVE NGA PARTI TJETËR

Qëndrimi i folësve ndaj personit ose argumentet e folësit në anën e kundërt, mund të ndikojnë në atmosferën e përgjithshme të debatit. Përkatësisht, format e shprehura të mosrespektimit mund të ndryshojnë rrjedhën e diskutimit dhe fokusin e deputetëve nga argumentet drejt sulmeve dhe fyerjeve, duke polarizuar në mënyrë shtesë atmosferën dhe duke parandaluar debatin thelbësor. Atmosfera korrekte dhe respekti i ndërsjellë është një parakusht themelor për zhvillimin e një debati racional dhe të arsyetuar.

Në më shumë se dy të tretat e fjalimeve (78%), deputetët nuk i marrin fare parasysh pohimet dhe deklaratat e kolegëve të tyre.


Në këtë periudhë, respektimi i argumenteve shprehet në më pak se 2% të fjalimeve. Respekti i pjesshëm është shprehur në 5% të rasteve, që është pak më shumë se në periudhën e mëparshme. Në periudhën e monitorimit, mosrespektimi i pjesshëm i argumenteve të bashkëbiseduesve nga një parti tjetër politike është përsëri në një nivel të lartë duke arritur në 10% të rasteve, përkatësisht rritje për 4% krahasuar me raportin e fundit. Mosrespektimi i argumenteve në periudhën janar - qershor 2025 është vërejtur në 8% të rasteve. Megjithatë, shumica e argumenteve të bashkëbiseduesve (78%), mbeten të pa referuara nga kolegët e tyre.

Grafiku 10. Qëndrimi ndaj argumenteve të deputetëve të tjerë (%)




Kur bëhet fjalë për qëndrimin e deputetëve ndaj personit të kolegëve të tyre nga një parti tjetër politike, vetëm në 2% e diskutimit është shprehur respekt, përkatësisht ka pasur një përmirësim të vogël në krahasim me periudhën e mëparshme të monitorimit. Respekti i pjesshëm u shpreh në 10% të diskutimit, që është një ndryshim i vogël nga periudha e mëparshme. Mosrespektimi i pjesshëm ndaj personalitetit të bashkëbiseduesit shprehet në 7% të diskutimit, ndërsa mosrespektimi i plotë shprehet në 4% të fjalimeve. Sipas këtyre rezultateve, janë të dukshme marrëdhënie njerëzore të përmirësuara në mënyrë marginale, në përbërjen e re parlamentare. Deputetët në 78% të diskutimit nuk iu referuan personalitetit të kolegëve të tyre nga kampi tjetër, që paraqet një rritje prej 1% krahasuar me periudhën e mëparshme.

Grafiku 11. Raporti ndaj deputetit/es të partisë tjetër politike (%)



Në periudhën korrik – dhjetor 2025, në 78% të fjalimeve të tyre, deputetët nuk iu referuan argumenteve dhe personalitetit të bashkëbiseduesit nga një opSION tjetër politik. Është vërejtur një respekt më i madh ndaj personit në raport me argumentet e bashkëbiseduesve, gjë që tregon se deputetët, për një nuancë të lehtë, i kushtojnë më shumë vëmendje përbajtjes së fjalimeve sesa karakteristikave personale të bashkëbiseduesit.

Grafiku 12. Raporti ndaj argumenteve dhe personalitetit të deputetëve të një partie tjetër politike (%)




■ RAPORTI NDAJ ARGUMENTEVE DHE PERSONALITETIT SIPAS LLOJIT TË PJESËMARRËSVE NË DISKUTIM

Deputetët e pushtetit në 92% të diskutimit, nuk iu referuan fjalimit të pjesëmarrësve të jashtëm. Mosrespektimi i pjesshëm ose i plotë i argumenteve të pjesëmarrësit të jashtëm u vërejt në 1.3% të fjalimeve të deputetëve të pushtetit, ndërsa në 7% të diskutimit ata shprehën respekt të pjesshëm ose të plotë. Deputetët e opozitës nuk kanë referencë në 90% të diskutimeve të tyre, ndërsa në 7% është vërejtur mosrespektim i pjesshëm ose i plotë. Në 3% të rasteve është shprehur respekt i pjesshëm ose i plotë i anëtarit të jashtëm.


Në pjesën më të madhe të diskutimeve të tyre, deputetët e pozitës dhe opozitës nuk iu referuan argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm.

Grafiku 13. Qëndrimi ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm sipas përkatësisë politike (%)



Deputetët e shumicës, në 92% të diskutimeve, nuk kanë pasur referenca ndaj personit të pjesëmarrësve të jashtëm; në 6% të fjalimeve kanë shprehur respekt të pjesshëm ose të plotë, ndërsa në 1% të fjalimeve kanë shprehur mos respekt të pjesshëm. Nga ana tjetër, deputetët e opozitës nuk kanë shprehur qëndrimin e tyre ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm në 88% të diskutimeve. Në 3% të rasteve, opozita ka treguar respekt apo respekt të pjesshëm për personalitetin e pjesëmarrësve të jashtëm, ndërsa mosrespektim apo mosrespektim të pjesshëm ndaj personalitetit të pjesëmarrësit të jashtëm është shprehur në 1% të diskutimeve.

Grafiku 14. Qëndrimi ndaj personalitetit të pjesëmarrësve të jashtëm sipas përkatësisë politike (%)



Deputetët edhe në këtë, si në periudhat e mëparshme, rrallë përdornin tregime, anekdota ose dëshmi në diskutimet e tyre. Elementë të tillë janë vërejtur në gjithsej 4% të diskutimeve.

Në diskutimet nuk u vërejt ndërprerje në fjalimet e folësve nga deputetë të tjerë. Në 3.5% të diskutimeve, është vërejtur kufizim i folësit në fjalimin e tij, shumica e këtyre ndërprerjeve ishin për shkak ndërhyrjeve pasive ndaj folësit. Në shumicën e fjalimeve (61%) të folësve, krahas fjalimit të tyre përdorin edhe gjestikulacione, ndërsa në 5% të diskutimeve vërehet përdorimi i rekuizitave në diskutim. Në 33% nuk ka gjeeste eksplicite, ndërsa në 2% gjestet u drejtohen të tjerëve.

Deputetët janë përgjithësisht të lirë dhe të pakufizuar në shprehjen e qëndrimeve të tyre në foltore.

VI.

**GRUPET E
MARGJINALIZUARA NË
KUVEND**



VI. GRUPET E MARGJINALIZUARA NË KUVEND

Gjatë monitorimit të cilësisë së debatit në Kuvend, kemi përfshirë në analizë grupet e margjinalizuara dhe sa deputetët u referohen nevojave dhe të drejtave të grupeve të margjinalizuara në fjalimet e tyre. Për këtë periudhë vëzhgimi, deputetët nuk adresuan të drejtat dhe nevojat e grupeve të margjinalizuara në 79% të fjalimeve të tyre, një përmirësim nga perioda e mëparshme kur përqindja arriti në 87%. Është vërejtur se deputetët në pjesën më të madhe të fjalimeve të tyre nuk adresojnë të drejtat e grupeve të margjinalizuara përveç nëse diskutohet specifikisht për ligj konkret ose temë në rend të ditës, në lidhje me të drejtat e tyre. Duke pasur parasysh se shumica e ligjeve ndikojnë në mënyra të ndryshme mbi grupe të ndryshme të qytetarëve, kur shqyrtohen pikat e rendit të ditës, deputetët duhet të trajtojnë më shumë aspekte që mund të prekin qytetarët nga grupet e margjinalizuara. Në diskutimet e monitoruara gjatë kësaj periudhe, më të përfshirë në diskutim, edhe pse në një përqindje të vogël, ishin të rinjtë (12.8%), banorët ruralë (2.5%) dhe gratë (2.4%). Ashtu si në të kaluarën, prindërit e vetëm dhe komuniteti LGBTI+ janë grupet më të margjinalizuara në fjalimet e deputetëve, me vetëm 1 fjalim për të parën dhe asnjë fjalim për këtë të fundit.

Deputetët trajtuan të drejtat dhe nevojat e grupeve të margjinalizuara në 21% të fjalimeve të tyre, që paraqet një përmirësim krahasuar me periudhën e mëparshme, kur kjo përqindje ishte 13%.

Megjithëse deputetët në përgjithësi rrallë u referohen të drejtave të grupeve të margjinalizuara dhe komuniteteve, megjithatë deputetët më shpesh u referohen këtyre komuniteteve për dallim nga kolegët e tyre deputetë. Kështu, 55% nga numri i përgjithshëm i fjalimeve që përfshijnë persona të margjinalizuar janë shprehur nga deputete femra. ►

► Tabela 2.

Grupet e marginalizuara	Fjalime (%)	Fjalime (Numra absolutë)
Të rinj	12.8	181
Banorët e zonave rurale	2.5	35
Gra	2.4	34
Persona me aftësi të kufizuara	2.3	32
Të rritur	2.1	30
Përdorues të ndihmës sociale	1.7	24
Romë	0.2	3
Të papunë	0.3	4
Prindër të vetëm	0.1	1
LGBTI +	0	0
Tjetër	1.5	21
Asnjë referim për grupet e marginalizuara	79.2	1118

VII.


DEMOGRAFIA E FOLËSVE



VII. DEMOGRAFIA E FOLËSVE

Struktura demografike e folësve, për nga përkatësia etnike, gjinore, arsimore dhe njësia zgjedhore e folësve ndryshon ndjeshëm krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2025. Deputetët nga komuniteti etnik maqedonas morën pjesë në 62% të debatit të përgjithshëm, deputetët nga komuniteti etnik shqiptar në 26%, ndërsa pjesëmarrja e komuniteteve të tjera etnike u regjistrua në 12% të diskutimit. Më aktivët janë deputetët nga njësitë zgjedhore 1 (16%), 2 (31%) dhe 6 (18%); krahasuar me periudhën e mëparshme të vëzhgimit, deputetët nga NJZ 2 e kanë rritur ndjeshëm pjesëmarrjen e tyre, gjë që konfirmon edhe rritjen e pjesëmarrjes së deputetëve me përkatësi etnike shqiptare. Pjesëmarrja e grave në diskutim si në periudhën e kaluar është rreth 36%, që është dukshëm më pak në vitet e kaluara kur arriti në 43%. Sa i përket arsimit, ekziston një pjesëmarrje më e lartë e dukshme e folësve me studime të doktoratës të përfunduara, nga të cilët mund të pritet një nivel më i lartë i argumentimit në fjalimet e tyre.

Grafiku 16. Struktura demografike e folësve (%)



VIII.

REKOMANDIME



VIII. REKOMANDIME

Kultura për debat e deputetëve të Kuvendin tonë, e mbështetur nga argumente të qarta dhe solide, me të cilat mbështet drejtpërdrejt pozicioni që ata përfaqësojnë, është në nivel relativisht të ulët. **Raportet e Institutit për Demokraci mbi cilësinë e debatit në përbërjen aktuale parlamentare tregojnë se një numër dominues i diskutimeve që zhvillohen në Kuvend janë përgjithësisht të argumentuara dobët, veçanërisht në pjesën e replikave dhe kundër-replikave.** Me fjalë të tjera, pjesa më e madhe e qëndrimeve që deputetët përfaqësojnë në Kuvend nuk mbështeten fuqishëm në prova dhe për to nuk ofrohen arsytetime të përshtatshme. Për këto arsye, është e nevojshme të rritet cilësia e debatit dhe niveli i argumentimit të fjalimeve të deputetëve në Kuvend. Ky raport mbi cilësinë e debatit në këtë pjesë përfshin disa rekomandime, por edhe mjete të disponueshme që janë në dispozicion të deputetëve për të arritur një nivel më të lartë të cilësisë së debatit.

Rritja e informimit dhe njohurive mbi temat që janë lëndë e diskutimit, si dhe përmirësim i aftësive debatuese dhe oratorike të deputetëve mund të kontribuojnë ndjeshëm për debat më të mirë në Kuvend. Instituti Parlamentar (IP) dhe Zyra parlamentare për buxhet (ZPB), të cilat funksionojnë në suazat e Kuvendit, ofrojnë shërbime që mund të adresojnë këto nevoja të deputetëve. Përkatësisht, IP dhe ZPB bëjnë hulumtime për tema me interes për deputetët, ndërsa IP ofron edhe edukim dhe trajnim në fusha të veçanta. Së këndejmi, paraqitet nevoja për përdorim më efikas dhe më efektiv të shërbimeve të IP-së dhe ZPB-së.

Kuvendi duhet të zbatojë në mënyrë aktive procesin e Vlerësimit të Ndikimit të Rregullativës (VNR), përmes së cilit do të rritet ndjeshëm cilësia dhe argumentimi i diskutimeve. VNR kontribuon në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes për rregullativat duke siguruar informacione mbi efektet dhe pasojat e masave të reja rregullatore, dhe bën vlerësimin dhe monitorimin e rregullativave ekzistuese. Ky mjet përdoret nga Qeveria, si propozuesi dominant i zgjidhjeve ligjore në vend, por jo edhe nga Kuvendi. Për këto arsye, Kuvendi është vendosur në rolin e vlerësuesit të propozimeve të Qeverisë, por është përgjithësisht jo konsistente në këtë rol, pasi argumentet e deputetëve nuk përqendrohen mjaftueshëm në përmbajtjen e rregullativave të propozuara ose diskutimi është argumentuar dobët.¹⁹ Së këndejmi, aplikimi i VNR në Kuvend dhe praktikimi aktiv i VNR nga deputetët si propozues të zgjidhjeve ligjore, do të mundësojë diskutim më të argumentuar dhe miratim të vendimeve me informim të mirë.²⁰ Në këtë drejtim, hulumtimi i Institutit Parlamentar (IP) dhe Zyrës Parlamentare të Buxhetit (ZPB) që vepron brenda Kuvendit mund të kontribuojë në gjithëpërfshirjen e procesit të VNR-së.

¹⁹ Dimeski, Jane, "Entrenched Debate - Analysis of the Quality of the Discussion in the Parliament June 2014 - May 2015", IDSCS, (2015), available at <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2009/08/rovovska-debata-mk.pdf>

²⁰ Bliznakovski, Jovan "Comparative good practices in the application of PVR and the possibility of their implementation in Macedonia", IDSCS, (2017), available at <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/>

Deputetët duhet të përdorin me kujdes dhe në mënyrë minimale procedurën e shkurtuar dhe procedurën për rishikimin e propozim - ligjeve me flamurin Evropian. Procedura e shkurtuar dhe ajo urgjente e reduktojnë kohën për debat, parashikojnë afate më të shkurtra për përfundimin e diskutimit, ndërsa në disa raste votohet edhe pa debat. Në vitet e mëparshme të monitorimit të cilësisë së debatit, por edhe në Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut, është vërejtur përdorim i tepruar i procedurës me flamur evropian.²⁰ Edhe pse ky trend nuk është vërejtur në vitin e fundit të vëzhgimit, nevojitet kujdes për të siguruar që një praktikë e tillë të mos përsëritet. Keqpërdorimi i këtyre mekanizmave e kufizon debatin ndërmjet deputetëve, ndikon negativisht në cilësinë e tij, ua cenon të drejtën e fjalës deputetëve dhe i privon nga mundësia për të marrë vendime të informuara. Një keqpërdorim i tillë në mënyrë të pashmangshme rezulton me zgjidhje ligjore të nxituara dhe të papërshtatshme. Njëkohësisht, praktika të tilla kontribuojnë në një perceptim më negativ nga ana e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Rritja e rolit mbikëqyrës të Kuvendit është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e masave strategjike të marra nga Qeveria, siç është Agjenda e Reformave në kuadër të Planit të ri për Rritje. Kuvendi, si organ përfaqësues dhe mbikëqyrës, duhet të monitorojë dhe vlerësojë në mënyrë proaktive mënyrën se si Qeveria krijon, zbaton dhe ndërton këto politika strategjike. Kjo nënkupton jo vetëm rishikimin e raporteve, por edhe organizimin e debateve tematike, shtrimin e pyetjeve të sakta të deputetëve dhe përdorimin e mekanizmave të llogaridhënies politike. Në të njëjtën kohë, është thelbësore që Kuvendi të përfshihet në planifikimin dhe miratimin e reformave në kohën e duhur, në mënyrë që të sigurohet transparenca, llogaridhënia dhe një konsensus më i gjerë politik dhe shoqëror për proceset e reformave që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe institucional të vendit.

Është thelbësore që deputetët të mbindërtohen me profesionalizëm dhe të kuptojnë për ndikimin e ligjeve mbi jetën e grupeve të ndryshme qytetarësh. Pjesërisht, këtë mund ta arrijnë me përdorimin e analizave të Institutit Parlamentar dhe Zyrës Buxhetore Parlamentare (ZBP). Në mënyrë plotësuese, gjithashtu duhet t'i kërkojnë VNR Raportet të përgatitura nga Qeveria dhe të konsultohen me shërbimet parlamentare me përvojë, qytetarë dhe sektorin joqeveritar mbi ndikimin e ligjeve. Gjatë debatit vlerë të shtuar paraqet përdorimi i shembujve nga përvoja, shqetësimet ose interesat e votuesve (zyra për komunikim me qytetarët, histori personale, storje mediatike, biznese lokale), si dhe reagimi dhe ballafaqimi përkatës ndaj vërejtjeve ose fjalimeve seksiste apo diskriminuese në Kuvend. Në këtë drejtim, vlera e shtuar do të ishte përdorimi i mekanizmit për seanca legislative publike të rregulluara me Rregulloren e punës së Kuvendit, ku komisionet amë mund të organizojnë seanca publike në lidhje me ndonjë propozim-ligj.

²¹ Meta (2023). Gere: The concern with using the European flag is when there is no compliance with European regulation. Accessed at: <https://meta.mk/gir-zagrizenosta-za-koristenjeto-evropsko-znamence-e-koga-nemausoglasuvanje-so-evropskata-regulativa/>

Deputetët, përveç ekspertizës së IP-së dhe ZBP-së, kanë në dispozicion disa mjete për të forcuar kapacitetin e tyre për shqyrtimin dhe debatimin në lidhje me ligjet, përfshirë trajnimet që i ofron Programi për Mbështetje Parlamentare (PSP), mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunimi (SDC). Ky program mund t'u ofrojë deputetëve trajnime për analizë të politikave dhe harmonizim me legjislacionin e BE-së, trajnim mbi analizën e ndikimit të ligjeve (AVL), ndikimin mbi barazinë gjinore dhe implikimet buxhetore të ligjeve, simulimet për VNR për shërbimin parlamentar dhe kanalin e Kuvendit, mbështetjen e Kuvendit për përfshirjen e VNR-së mbi ligjet e propozuara, si dhe forcimin e njohurive dhe aftësive për debat të argumentuar, përfshirë aftësitë për të folur në publik dhe bashkëpunim me mediat. Çdo përbërje parlamentare e sapo zgjedhur, siç është ajo aktuale që është objekt monitorimi në këtë raport, ka në radhët e saj një përqindje të konsiderueshme të deputetëve që janë për herë të parë në këtë funksion. Për këta deputetë, përveç trajnimeve të rregullta hyrëse, fokusi duhet të jetë në mënyrën në të cilën ata duhet të paraqesin dhe justifikojnë pikëpamjet e tyre, si dhe në mjetet në dispozicion të tyre për të mbështetur përgatitjen e fjalimeve të tyre dhe mekanizmat ekzistues për përmirësimin e prezantimeve të tyre. Ky raport mund të shërbejë si pikë referimi për të kuptuar nëse deputetët e rinj (dhe të gjithë deputetët në përgjithësi), gjatë shqyrtimit të cilësisë së fjalimeve të tyre në fillim dhe në fund të mandatit, kanë përmirësuar gjatë viteve aftësitë e tyre oratorike, si dhe mënyrën dhe mbështetjen e fjalimeve të tyre.

Së fundi, duhet të ketë kalendar të seancave parlamentare. Rregullorja e re e Kuvendit e parashikon këtë mjet, mbetet përcaktimi i deputetëve për ta inkuorporuar dhe për ta vënë në funksion. Kalendar i seancave do të sigurojë parashikueshmëri të punës së Kuvendit si dhe më shumë kohë për deputetët, për përgatitje për pikat e rendit të ditës. Me kohën në dispozicion dhe parashikueshmërinë më të madhe, deputetët do të mund të informohen me kohë për propozim-ligjet, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve, raportet e trupave rregullatore dhe të pavarura dhe aktet tjera në Kuvend. Parashikueshmëria e seancave do të kontribuojë për diskutim më cilësor dhe më të argumentuar.

IX. SHTOJCA 1 - INDEKSI I CILËSISË SË DEBATIT

Indeksi i cilësisë së debatit është indeks i përbërë i përbërë nga disa tregues që rezultojnë nga monitorimi i debatit. Indeksi ndodh në disa faza ku faza e fundit është shuma e vlerave të ponderuara të treguesve individualë. Indeksi përfshin:

Tabela 1.

Emri	Shkalla	Pjesëmarrja në shumën përfundimtare (%)
Shkalla e arsyetimit	[-1:1]	20
Përfshirja e arsyetimit	[-1:1]	5
Përgjegjësi	[-1:1]	20
Fuqia e argumentit më të mirë	[-1:1]	20
Qëndrimi ndaj pjesëmarrësve të partie tjetër	[-1:1]	10
Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të partisë tjetër	[-1:1]	10
Raporti ndaj pjesëmarrësve të jashtëm	[-1:1]	2,5
Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm	[-1:1]	2,5
Ndërprerje	[-1:1]	5
Kufizim	[-1:1]	5

Për qëllime të indeksimit, secilit prej indikatorëve iu caktuan rezultatet për kategoritë individuale. Vlerësimet janë dhënë në tabelën vijuese:

Tabela 2.

Shkalla e arsyetimit	notat	Përfshirja e arsyetimit	notat
më shumë se 2 argumente	4	parime abstrakte	2
2 argumente	3	e mirë e përgjithshme	2
1 argument	2	grupe të tjera	1
dobët	0	grup vetanak	1
nuk ka	-2	neutrale	0

Përgjegjësi	notat	Fuqia e argumentit më të mirë	notat
adreson argumente në mënyrë të përshtatshme	2	ndryshim për shkak të argumenteve	5
pjesërisht i injoron, shtrembëron, adreson argumentet	1	asnjë ndryshim, me pozicion të ndryshëm, pranon argumente	3
nuk u adresuan argumente nga folës tjetër	0	asnjë ndryshim, qëndron në pozicionin e vet, pranon argumentet	1
injoron argumentet	-1	asnjë ndryshim, nuk pranon argumente	0
nuk injoron arg. por i shtrembëron	-2	ndryshim por jo për shkak të argumenteve	0
		asnjë referencë	0

Qëndrimi ndaj pjesëmarrësve të partie tjetër	notat	Raporti ndaj pjesëmarrësve të jashtëm	notat
respektim eksplisit	2	respektim eksplisit	2
respektim	2	respektim	2
respektim i pjesshëm	1	respektim i pjesshëm	1
asnjë referencë	0	asnjë referencë	0
mosrespektim i pjesshëm	-1	mosrespektim i pjesshëm	-1
mosrespektim	-2	mosrespektim	-2

Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të partisë tjetër	notat	Raporti ndaj argumenteve të pjesëmarrësve të jashtëm	notat
respektim eksplisit	2	respektim eksplisit	2
respektim	2	respektim	2
respektim i pjesshëm	1	respektim i pjesshëm	1
asnjë referencë	0	asnjë referencë	0
mosrespektim i pjesshëm	-1	mosrespektim i pjesshëm	-1
mosrespektim	-2	mosrespektim	-2

Kufizim	notat	Ndërprerje	notat
nuk ka	0	nuk ka ndërprerje	0
ka pengim pasiv	-1	ka ndërprerje	-1
ka folësi sugjeron se është penguar	-1		
ka ndërprerje fizike	-2		

Secili nga këta indikatorë u shndërrua në mënyrë lineare në nën-indekse në shkallë prej -1 në 1, duke mbajtur llogari gjatë transformimit që nota origjinale të mos humbte shenjën pozitive ose negative. Prandaj, formula universale e transformimit është:

$$i = \frac{2 \times \text{indicator}}{(\max - (-\max))}$$

për të gjithë indikatorët përveç ndërprerjes dhe kufizimit sepse në këta dy indikatorë vlera absolute e notës më të ulët të mundshme është më e madhe se vlera e notës më të lartë të mundshme. Prandaj formula është:

$$i = \frac{2 \times \text{indicator}}{(|\min| - (\min))}$$

Pas llogaritjes së nën-indekseve të indikatorëve individualë, për llogaritje do të kalkulohet shuma preDQI me vlerat e ponderuara të nën-indekseve sipas pjesëmarrjes së dhënë në Tabelën 1.

Për analizë më të lehtë, DQI përfundimtar transformohet në mënyrë lineare në shkallën nga 1 në 10 sipas formulës në vijim:

$$DQI = \frac{(10 - 1)}{(1 - (-1)) \times (\text{preDQI} - 1) + 10}$$

Këto llogaritje dhe transformime bëhen për secilin fjalim individualisht dhe raporti përcjell mesataren aritmetike të të gjitha fjalimeve nga periudha e monitoruar.

INFORMACIONE RRETH PROJEKTIT

Programi Zviceran për Mbështetje Parlamentare (PMP) do të mbështesë përpjekjet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për pavarësi përmes ndërtimit të konsensusit, reformave strukturore dhe ndërtimit të kapaciteteve në zhvillimin institucional të Kuvendit; në rolet e tij legjislativ dhe mbikëqyrës dhe në transparencën dhe llogaridhënien e tij institucionale. PSP-ja, zbatohet nga Instituti Demokratik Nacional, Instituti për Demokraci «Societas Civilis» - Shkup dhe Qendra për Menaxhim me Ndryshime, për mbështetjen e planifikimit strategjik të Kuvendit; për reforma në menaxhimin me burimet njerëzore; për vlerësimin e përmirësuar të ndikimit të rregullativës dhe proceset e prokurimit; për përkushtim ndaj të dhënave të hapura dhe përmes matjes së opinionin publik dhe monitorimit të përpjekjeve për reformë, përfshirë edhe për angazhimin më të madh qytetar në proceset e krijimit të politikave.

INFORMACIONE RRETH NDI-së

Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) është një organizatë që nga themelimi i tij në vitin 1983 punon për forcimin e demokracisë dhe mbështetjen e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse politike në mbarë botën. NDI është aktiv në Maqedoninë e Veriut që nga viti 1993, duke bashkëpunuar me qytetarët, shoqërinë civile, partitë politike, mediat dhe institucionet për të ndërtuar praktika demokratike më transparente, të përgjegjshme dhe të qëndrueshme. Sot, NDI zbaton Programin për Mbështetje Parlamentare dhe iniciativat “Komunitete me Integritet”, të mbështetura nga qeveritë e Zvicrës dhe Suedisë, me qëllim të avancimit të qeverisjes demokratike dhe integritetit në nivel kombëtar dhe lokal.

Të dhënat e kontaktit për NDI

Adresa: Rr. Lazar Liçenoski 13, Kat 3, 1000 Shkup
posta elektronike: ndimacedonia@ndi.org

INFORMACIONE RRETH IDSCS-Ë

Instituti për Demokraci «Societas Civilis» Shkup (IDSCS) është një organizatë think tank që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën participative politike. Përmes forcimit të vlerave liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve.

IDSCS, që nga qershori 2014, monitoron cilësinë e debatit në Kuvend dhe mbulimin mediatik të punës së Kuvendit. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua për 10 muaj, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015. Nga shtatori i vitit 2015 vijoi periudha e dytë e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së debatit parlamentar dhe mbulimit mediatik, mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që zgjati deri në dhjetor të vitit 2017. Periudha e tretë e monitorimit të cilësisë së debatit filloi në janar të vitit 2018 dhe zgjati deri në dhjetor të vitit 2019. **Që nga janari 2020, Instituti për Demokraci monitoron punën e Kuvendit dhe cilësinë e debatit në kuadër të Programit për Mbështetje Parlamentare (PSP).**

Të dhëna për kontakt - IDSCS

Adresa: rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 /2,
1000 Shkup
Tel. nr. / Faks: +389 2 3094 760,
posta elektronike: contact@idscs.org.mk

